



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

## **KURRKULA BËRTHAMË**

**Lënda: Letërsi**

**Shkalla: VI**

**Klasa: XII**

Tiranë, 2017



## TABELA E PËRMBAJTJES

|  |    |
|--|----|
| TABELA E PËRMBAJTJES.....  | 2  |
| I. HYRJE.....  | 3  |
| II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË LETËRSISË .....   | 5  |
| 1. Qëllimet e arsimit parauniversitar.....   | 6  |
| 2. Qëllimet e programit të letërsisë .....   | 7  |
| 3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës .....  | 7  |
| 4. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë..... | 9  |
| 5. Lidhja e letërsisë me temat ndërkurrikulare .....   | 14 |
| 6. Lidhja e letërsisë me fushat e tjera të të nxënit.....  | 15 |
| 7. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre.....   | 17 |
| 8. Ndarja e kohës mësimore për secilën klasë .....   | 18 |
| III. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË GJASHTË.....   | 20 |
| Klasa XII.....   | 20 |
| IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE .....   | 29 |
| V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN .....   | 32 |
| VI. ELEMENTET QË DO TË STUDIOHEN NË TEKSTET LETRARE .....  | 34 |
| 1. Autorët dhe veprat e sugjeruara në arsimin e mesëm e lartë .....  | 35 |
| 2. Leximet jashtë klase dhe bisedat letrare .....  | 36 |
| VII. MATERIALET, BURIMET MËSIMORE, MJEDISET E TË NXËNIT.....   | 38 |

## I. HYRJE

Lënda e letërsisë bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Letërsi me zgjedhje (klasa XII), Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen dhe zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Letërsia është një nga lëndët kryesore në arsimin e mesëm të lartë. Ajo ndikon në formimin estetik dhe letrar, në rritjen e aftësive krijuese dhe në pasurimin e aftësive shprehëse të nxënësve. Kjo lëndë, gjithashtu, mundëson krijimin e një raporti pozitiv dhe të qëndrueshëm mes nxënësve dhe artit të letërsisë.

Letërsia zhvillohet nga klasa e dhjetë deri në klasën e dymbëdhjetë. Programi i saj mbështetet në njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që nxënësit kanë fituar në arsimin bazë. Në ciklin 9-vjeçar, letërsia mësohet e integruar me gjuhën shqipe. Në arsimin e mesëm të lartë, letërsia studiohet si veprimtari krijuese, subjektive dhe e vetëmjaftueshme. Ajo shihet e lidhur me zhvillimin historik e shoqëror, me filozofinë e kohës, por jo si mjet i thjeshtë që ilustron historinë.

Letërsia, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të cilat janë të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision”, lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj.

Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së letërsisë, kompetencat e saj janë:

- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve<sup>1</sup> të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Në arsimin bazë, nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet vazhdimisht, gjatë gjithë jetës, dhe nuk ka pikëmbërritje. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit kanë para tyre sfida të reja. P.sh., ata njohin dhe analizojnë në mënyrë më të thelluar vepra të gjinive letrare

---

<sup>1</sup> Tekste poetike, tekste në prozë dhe tekste dramatike

të ndryshme (që janë në përputhje me zhvillimin e tyre), gjykojnë për periudhat dhe drejtimit e ndryshme letrare, vlerësojnë krijimtarinë letrare të autorëve të ndryshëm etj.

Programi i letërsisë bazohet në parimin e integritit të njohurive dhe në parimin e rimarrjes së tyre vit pas viti duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

## II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË LETËRSISË

Hartimi i programit të letërsisë mbështetet në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, në kurrikulën bërthamë dhe në planin mësimor të gjimnazit. Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë.

**Mësuesit** do ta përdorin programin e letërsisë për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të përmbushur kërkesat e programit.

**Autorët e teksteve** do ta përdorin programin e letërsisë për të hartuar tekste shkollore që janë në funksion të analizës së plotë dhe funksionale të veprave dhe të autorëve.

**Prindërit dhe komuniteti**, nëpërmjet programit lëndor, mund të informohen për njohuritë, aftësitë dhe vlerat që marrin fëmijët e tyre në lëndën e letërsisë.

**Specialistët e arsimit** mund ta përdorin programin e letërsisë për qëllime inspektimi, vlerësimi, monitorimi, studimi etj.


**Fakultetet e mësuesisë** mund ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën pedagogjike të studentëve.

Programi i letërsisë ka në fokus realizimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyçe dhe të kompetencave të lëndës do të realizohen edhe temat ndërkurrikulare, të cilat mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, me shoqërinë dhe me tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e letërsisë me lëndët e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të lëndës. Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave. Në program është sugjeruar edhe shpërndarja e orëve mësimore.

Diagrami i mëposhtëm paraqet organizimin e programit të letërsisë.



## 1. Qëllimet e arsimit parauniversitar

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak e kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;

- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

## 2. Qëllimet e programit të letërsisë

Nëpërmjet studimit të letërsisë në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit:

- lexojnë dhe interpretojnë vepra e fragmente nga gjini të ndryshme letrare, nga krijimtaria e autorëve që janë përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore;
- vlerësojnë rëndësinë shoqërore, historike dhe kulturore të letërsisë dhe të shkrimtarëve si krijues;
- vlerësojnë letërsinë si një mënyrë për të pasuruar botën e tyre emocionale, si dhe për të zhvilluar imagjinatën dhe të menduarit kritik;
- lexojnë poezi, prozë, dramë dhe dallojnë tiparet kryesore të tyre;
- analizojnë shumëllojshmërinë e mjeteve të shprehjes artistike dhe dallojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes letërsisë dhe arteve të tjera (teatër, muzikë, art pamor);
- zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë dhe bëhen të vetëdijshëm për shumësinë e mënyrave të perceptimit të botës përreth tyre;
- gjykojnë për vlerat estetike të gjuhës në një tekst letrar;
- lidhin tekstin që lexojnë me jetën e përvojat e tyre, si dhe me botën që i rrethon;
- analizojnë tekste të ndryshme letrare dhe zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese me gojë dhe me shkrim;
- interpretojnë vlerat tërësore të veprave që marrin karakter gjithëkohor dhe që transmetojnë mesazhe përtej kohës së tyre;
- aftësohen për të qenë qytetarë të denjë për shoqërinë dhe për tregun e punës.

## 3. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës


Realizimi i kompetencave kyçe të kornizës kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për ta përmbushur në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të nxënies. Kur nxënësi përmbush kompetencat e lëndës së letërsisë, ai zhvillon njëkohësisht edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimit të një projekti ose detyre në grup, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit e të komunikimit dhe zhvillon, kështu, edhe

kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, në shoqëri dhe në punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatin/rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- përcakton rezultatin e të nxënit të kompetencave kyçe për vit mësimor duke zbërthyer rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallë mësimore (janë përcaktuar në program);
- përzgjedh përmbajtjen/përmbajtjet mësimore, mjetet didaktike dhe metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor në lëndën e letërsisë.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës.





#### 4. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit dhe lëndëve mësimore. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi”, ku bën pjesë edhe lënda e letërsisë, ndihmon në realizimin e të gjitha kompetencave, por, më së shumti, të kompetencës së komunikimit dhe të të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së pestë dhe shkallës së gjashtë.

| Shkalla V  | Shkalla VI   |
|--|--|
| <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>  |  |
| <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shprehet përmes një forme komunikimi për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në material;</li> <li>- diskuton në grup në mënyrë konstruktive, në kohëzgjatje jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë nga 3-5 paragrafë, u përgjigjet pyetjeve të shtruar për llojin e tekstit dhe stilin e të shkruarit, tregon qëllimin dhe lidhjen ndërmjet përmbajtjes së paragrafëve;</li> <li>- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës amtare në kontekste dhe në forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, <i>e-mail</i> (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të njohur në një gjuhë të huaj ose në gjuhën amtare, si dhe tregon me shembuj konkretë disa nga ngjashmëritë ndërmjet strukturës së fjalisë së asaj gjuhe me gjuhën amtare;</li> <li>- shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me tre deri pesë paragrafë,</li> </ul> | <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpreh para një audience të caktuar mësimore çështjet kryesore të ngritura në një fjalim ose interpretim të dëgjuar për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes të paktën një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike etj.);</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të panjohur në gjuhën e huaj, i cili përmban 2-3 faqe (tregim letrar, tekst argëtues, artikull gazete ose reviste etj.), identifikon ngjashmëritë dhe dallimet kryesore në strukturën e fjalive në gjuhën e huaj dhe në gjuhën amtare, duke nënvizuar dhe duke ilustruar me shembuj konkretë;</li> <li>- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe të gjuhës së huaj në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, <i>e-mail</i>, letër formale dhe joformale etj.;</li> <li>- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafësh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin dhe leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që bart çdo paragraf;</li> </ul> |

|   |   |
|---|---|
| <p>duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të esesë;</li> <li>- prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj.) për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, duke përdorur në mënyrë efektive teknologjinë informative dhe teknologji të tjera;</li> <li>- përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënësit e informacioneve të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe komunikon në mënyrë efektive me audiencën duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike;</li> <li>- shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë e me shkrim, të artit pamor, muzikor, skenik, krijimin letrar etj.;</li> <li>- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, si p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë;</li> <li>- përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënies dhe kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.</li> </ul> |
|---|---|

### Kompetenca e të menduarit

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e mbledhjes, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacionit për fusha të ndryshme mësimore apo për një temë të caktuar;</li> <li>- ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, kultura, arti, sporti, shëndetësia, shoqëria, mjedisi etj.);</li> <li>- krahason të paktën tri burime të ndryshme informacioni për trajtimin e temës, argumenton saktësinë dhe rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kritere të përcaktuara më parë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të</li> </ul> | <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen përmes metodës së analizës, dhe e prezanton para moshatarëve apo para të tjerëve;</li> <li>- analizon në mënyrë të pavarur informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë: orientimi në karrierë, integrimet europiane, ndryshimet klimatike, rreziqet nga armët konvencionale, armatimi bërthamor, zhvillimi kulturor-artistik në vend etj.);</li> <li>- hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat</li> </ul> |
|---|--|

|   |   |
|---|---|
| <p>ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore, duke e zbërthyer në hapa të vegjël, dhe jep sqarime të nevojshme për hapat e ndjekur në zgjidhjen e problemit, duke përdorur forma të ndryshme të shprehurit;</li> <li>- krijon një vepër artistike me pamje dy-dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore dhe shpjegon para moshatarëve hapat e ndjekur për krijimin e veprës.</li> </ul> | <p>dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë e informacionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem, duke dhënë shembuj konkretë.</li> </ul> |
|---|---|

### Kompetenca e të nxënit

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo veprimtarie dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;</li> <li>- shfrytëzon në mënyrë efektive përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme apo gjatë kryerjes së ndonjë detyre ose veprimtarie në ndonjë fushë të caktuar mësimore;</li> <li>- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), me jo më pak se 900 fjalë, për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, veçon në fund të përmbledhjes disa çështje që vërtetojnë përparimin e vet dhe disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e mëtejshëm;</li> <li>- shfrytëzon në mënyrë të pavarur dhe efektive teknologjinë e informacionit dhe burime të tjera informacioni për të mbledhur materiale për zgjidhjen e një problemi apo detyre të caktuar, të cilat, më pas, i analizon, i klasifikon dhe i paraqet para të tjerëve përmes TIK-ut dhe ndonjë forme tjetër të shprehjes;</li> </ul> | <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një plani të shtëpisë, për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.);</li> <li>- diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë mësimore të re ose një problem nga jeta e përditshme, ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarë; tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla;</li> <li>- shfrytëzon në mënyrën e duhur këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;</li> <li>- përpunon në mënyrë të pavarur dhe efektive informacionet për një temë të caktuar;</li> <li>- paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje</li> </ul> |
|--|---|

|   |   |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- kërkon dhe shfrytëzon në mënyrën e duhur këshilla dhe informacione për kapërcimin e vështirësive në të nxënë në një fushë të caktuar dhe më pas prezanton rezultatet e arritura;</li> <li>- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie të caktuar, duke dhënë mendime të argumentuara për rezultatet e pritshme (në formë skice, grafiku, vizatimi, shkrimi, veprë artistike etj.);</li> <li>- shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, ose për të zgjidhur një problem që kërkohet prej tij, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare (p.sh.: burime informacioni në libër, revistë, enciklopedi, internet, hartë, grafik, skicë, partiturë muzikore, skenar etj.).</li> </ul> | <p>të caktuar (p.sh.: për vlerat kulturore të rajonit të vet, për vlerat e edukimit në shoqëri etj.), duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit, dhe e paraqet para të tjerëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka përdorur për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e zbatuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;</li> <li>- vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., redakton në mënyrë të pavarur një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.;</li> <li>- menaxhon në mënyrë produktive burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e konkretizimit/të punës etj.), gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyrë të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.</li> </ul> |
|---|---|

### Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- harton një projekt me faza të mirëmenaxhuara (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer përvojë, duke u konsultuar me të tjerët dhe duke i informuar ata, si dhe duke identifikuar dhe vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe monetare në përputhje me rezultatet e pritshme;</li> <li>- merr pjesë në veprimtari të ndryshme në nivel klase, shkolle, komuniteti dhe më gjerë (konkurse mësimore, gara sportive, veprimtari kulturore, muzikore etj.);</li> <li>- diskuton me të tjerët për procesin e organizimit të veprimtarive dhe për rezultatet e arritura, si dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse si të përmirësohet procesi i organizimit dhe si të rritet pjesëmarrja në veprimtari.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- paraqet, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillim të karrierës në një fushë të caktuar;</li> <li>- merr nisma të suksesshme për organizimin e veprimtarive të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.</li> </ul> |
|---|--|

## Kompetenca personale

### Nxënësi:

- merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive apo në veprimtari të tjera kulturore dhe menaxhon në mënyrë konstruktive emocionet e veta;
- ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

### Nxënësi:

- tregon shkathtësi në organizimin e lojërave me të tjerët, garave sportive, apo veprimtarive kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë jetës së përditshme;
- prezanton, në forma të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen;
- shpreh në forma të ndryshme qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/kujdestar, për planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.

## Kompetenca qytetare

### Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet, në lokal dhe në nivel shtetëror); tregon, gjatë diskutimit, tolerancë dhe respekt për pyetjet dhe komentet e të tjerëve;
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe më gjerë) dhe i shpjegon ato në një debat me të tjerët;
- diskuton me të tjerët apo në një formë tjetër të të shprehurit paraqet interesin

### Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë;
- paraqet, në forma të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të shumëllojshmërisë në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale

|   |   |
|---|---|
| personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj. dhe jep propozime për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunitet e më gjerë në një fushë të caktuar.  | dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri.  |
| <b>Kompetenca digjitale</b>   |   |
| <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;</li> <li>- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet paraqitjeve filmike apo të animuara;</li> <li>- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;</li> <li>- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe në mediat digjitale.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënit, duke përfshirë edhe të nxënit në distancë;</li> <li>- vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;</li> <li>- është aktiv dhe i pavarur në procesin e të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.</li> </ul> |

## 5. Lidhja e letërsisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë një mënyrë për të integruar kompetencat kyçe në fushat e të nxënit ose lëndët mësimore. Ato janë çështje të rëndësishme, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Trajtimi i temave ndërkurrikulare i ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Letërsia, për specifikat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore që mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme letrare nga

letërsia shqipe dhe ajo botërore zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar dhe njohjen e vlerësimin e kulturës botërore. Tema, si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup në orë të ndryshme mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata të nxëni, gjatë të cilave nxënësit shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e letërsisë, ndihmojnë në aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

## **6. Lidhja e letërsisë me fushat e tjera të të nxënit**

Lënda e letërsisë lidhet me shumë lëndë të arsimit të mesëm të lartë. Natyrisht, letërsia ka lidhje, më së shumti, me lëndët që përbëjnë fushën “Gjuhët dhe komunikimi”, pra me gjuhën shqipe dhe me gjuhët e huaja. Ekzistenca e letërsisë dëshmohet pikërisht nëpërmjet gjuhës si materie kryesore dhe jashtë saj ajo nuk mund të krijohet, të ekzistojë, të komunikojë dhe as të ndikojë estetikisht. Nga ana tjetër, letërsia përbën një material të rëndësishëm për gjuhësinë, pasi i shërben si objekt analize dhe si dëshmi e shfaqjes së dukurive gjuhësore të ndryshme në periudha kohore të ndryshme.

Studimi i veprave të disa autorëve të letërsisë botërore mund të zgjojë te nxënësit interes për gjuhën dhe kulturën e atij vendi, duke zbuluar kështu një nga lidhjet mes letërsisë dhe gjuhës së huaj.

Studimi i letërsisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të vlerësojnë natyrën. Shpesh, natyra dhe bukuritë e saj shërbejnë si burim frymëzimi për shkrimtarët. Leximi dhe studimi i këtyre krijimeve artistike tërheq vëmendjen e nxënësve drejt bukurive dhe vlerave të natyrës. Kjo do të thotë që kjo lëndë mund të integrohet me shkencat e natyrës dhe me lëndët që përfshihen në atë fushë.

Letërsia si lëndë mësimore mbështet studimin e shkencave shoqërore në mënyra të ndryshme. Leximi i veprave letrare ndikon në formimin dhe ndryshimin e botëkuptimeve, në kuptimin e ngjarjeve dhe të personaliteteve historike, si dhe në orientimin në jetën shoqërore dhe në marrëdhëniet njerëzore. Shpeshherë, letërsia është parë si një nga format e shprehjes së mendimit filozofik, sepse krijimtaria letrare ka qenë një mundësi e mirë për shprehjen e ideve filozofike. Mjaft shkrimtarë kanë qenë edhe filozofë të mëdhenj, si p.sh.: Volteri, Shiler, Niçe, Sartri, Kamy etj. Ekzistencializmi i Kamysë dhe i Sartrit ka gjetur shprehje jo vetëm në traktate filozofike, por edhe në krijimtarinë e tyre letrare.

Artet dhe studimi i tyre mbështeten nga studimi i letërsisë (si një nga artet). Analiza e veprave letrare mbështet kuptimin e “mjetit artistik”, si një term i përbashkët i të gjithave arteve, i cili

përdoret nga artistët për të përcjellë mesazhet e tyre. Analiza e ilustrimeve (pamje, piktura etj.) në vepra të ndryshme letrare dhe shpjegimi i funksioneve të tyre mbështet kuptimin e specifikave të arteve të bukura dhe mjeteve të tyre të shprehjes. Ilustrimi i analizave letrare me muzikën e një periudhe të caktuar i ndihmon nxënësit që të kuptojnë efektin emocional të muzikës, si dhe karakteristikat e veçanta të rrymave të ndryshme muzikore.

Kjo do të thotë që zbatuesit e këtij programi (më së shumti, mësuesit) duhet të realizojnë parimin e integritit të letërsisë me njohuri, aftësi dhe shkathhtësi të lëndëve të tjera, të tilla si: gjuhë shqipe, arte, gjuhë të huaja, teknologji, shkenca shoqërore etj.

Më lart është përshkruar ndikimi ose mbështetja e letërsisë në funksion të fushave ose lëndëve të tjera mësimore. Lënda e letërsisë, jo vetëm mbështet, por edhe përdor njohuri dhe aftësi që nxënësit kanë marrë në fushat/lëndët e tjera.

Më konkretisht, këto njohuri dhe aftësi janë dhënë në diagramin e mëposhtëm:





## 7. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Lënda e letërsisë synon të formojë dhe të zhvillojë te nxënësit dy kompetenca:

- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Puna për zhvillimin e këtyre kompetencave nuk duhet të bëhet e ndarë dhe e fragmentarizuar. Në procesin mësimor, gjatë çdo ore mësimore punohet për formimin e të dyja kompetencave. Kështu p.sh., nxënësi analizon dhe interpreton një poemë të Bajronit me të gjitha veçoritë e saj dhe, gjithashtu, gjykon dhe vlerëson tiparet kryesore të krijimtarisë së Bajronit dhe të letërsisë romantike. Pra, nxënësi e studion veprën në thellësi, por edhe raportin e saj me krijimtarinë e autorit dhe me periudhën letrare ose historike.

## Përshkrimi i kompetencave

### a) Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit fitojnë teknikat e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë në shkollë dhe në jetë. Ata analizojnë dhe interpretojnë, si lexues kritikë dhe të pavarur, vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë aftësitë e nevojshme për ta kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare, nxënësi nuk i mëson thjesht në mënyrë teorike, por të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare. Gjatë tri viteve, nxënësit do të lexojnë dhe do të punojnë me tekste poetike, dramatike dhe tekste në prozë.

Gjatë analizës dhe interpretimit të veprave letrare, nxënësit dallojnë edhe mjetet e shumta e gjuhës, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht të bukura.

### b) Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Nxënësit krijojnë një pasqyrë të qartë:

- të fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore;
- të lidhjeve mes periudhave të ndryshme historike dhe drejtimeve letrare;
- të gjinive letrare, të autorëve dhe veprave më përfaqësuese të një periudhe historike ose të një drejtimi letrar.

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, mësimi i letërsisë përqendrohet në karakteristikat kryesore të një periudhe, duke u dhënë mundësi nxënësve të krijojnë një ide të përgjithshme rreth origjinës, përhapjes dhe tipareve të një drejtimi letrar, si dhe të gjinive e të llojeve që lëvrohen.

Përzgjedhja e veprave letrare që studiohen **përgjatë tri viteve**, bëhet duke respektuar një raport të drejtë mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore. Letërsia shqipe do të studiohet paralelisht me letërsinë botërore duke u kushtuar vëmendje të përbashkëtave dhe dallimeve mes tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të kuptojnë që letërsia shqipe nuk është një njësi e veçuar dhe e ndarë, por pjesë e pasurisë letrare botërore.

## 8. Ndarja e kohës mësimore për secilën klasë

Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore për shkallën e pestë dhe për shkallën e gjashtë (klasat X-XII).

| Klasa/ shkalla | X  | XI | Shkalla V  | XII | Shkalla VI |
|----------------|----|----|------------|-----|------------|
| Orë/javë       | 2  | 2  | 4          | 2   | 2          |
| Orë gjithsej   | 72 | 72 | <b>144</b> | 68  | <b>68</b>  |

Koha mësimore përdoret:

- për njohuri të reja;
- për përsëritje;
- për dramatizime;
- për biseda letrare;
- për testime;
- për ese;
- për projekte etj.

Analiza dhe studimi i veprave letrare që janë sugjeruar në program (së bashku me jetën dhe veprimtarinë e autorit), sugjerohen që të zhvillohen afërsisht **5 orë mësimore**. Në lëndën e letërsisë, gjatë çdo orë mësimi nxënësit ndërtojnë dhe zhvillojnë të dyja kompetencat lëndore.

### III. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË GJASHTË



#### Klasa XII

*Shënim:* 6 orë mësimore do të përdoren për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore. Këto orë mund të planifikohen përgjatë vitit shkollor ose në fund të tij.

**KOMPETENCA: ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TEKSTEVE TË GJINIVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME LETRARE**

#### Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- bën dallimin mes llojeve dhe gjinive letrare në veprat që studion dhe i analizon ato duke u mbështetur në karakteristikat e llojit dhe të gjinisë;
- analizon lloje të ndryshme prozash, si dhe jep shembuj të autorëve që i kanë lëvruar;
- përcakton temën dhe idetë, analizon personazhet dhe marrëdhëniet mes tyre, i lidh elementet e mësipërme me jetën dhe botën rreth tij, ilustron me detaje nga teksti idetë dhe interpretimet e tij;
- përcakton gjininë dhe motivet kryesore në tekstet poetike, formulon idetë e tij dhe analizon gjuhën e figurshme;
- shpjegon elementet e tekstit letrar dhe figuracionin letrar dhe i përdor ato gjatë analizës së gjuhës dhe stilit të këtyre veprave.

| Njohuritë   | Shkathësitë <sup>2</sup>   |
|---|--|
| <b>Elementet e tekstit letrar</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Fabula dhe subjekti. Dallimi mes tyre.</li><li>- Tema dhe motivet.</li><li>- Rrëfimtari, autori dhe lexuesi.</li><li>- Format e rrëfimit.</li><li>- Sistemi i personazheve. Marrëdhëniet kryesore mes personazheve.</li></ul> | <b>Elementet e tekstit letrar</b> <p><b>a) Fabula dhe subjekti</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- rrëfen dhe analizon subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;</li><li>- përcakton dhe analizon fabulën e një teksti;</li><li>- bën dallimin mes fabulës dhe subjektit;</li><li>- analizon ngjarjet kryesore të një teksti;</li></ul> |

<sup>2</sup> Veprat për të cilat nxënësit do të marrin njohuri dhe do të demonstrojnë shkathësi, vlera ose qëndrime, janë dhënë në një tabelë në fund të programit.

- Mjedisi, koha dhe atmosfera.
- Stili. Gjuha e një veprë letrare.
- Llojet e poezisë lirike.
- Poema epike.
- Ritmi dhe vargu (edhe vargu i lirë). Rima dhe llojet e saj.
- Strofa, funksioni dhe llojet e saj.

**Shënim.** Këto njohuri merren gjatë studimit dhe analizës së veprave letrare.

- dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre;
- dallon konfliktin/konfliktet në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;
- analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;
- përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori;
- shpjegon efektet e teknikave të tilla në organizimin ose strukturën e tekstit letrar, si p.sh.: dukurinë e anakronisë (*flashback*-ut), paralajmërimit etj.

#### **b) Personazhet**

Nxënësi:

- analizon dhe vlerëson personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe në mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;
- analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh;
- evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);
- analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër;
- dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, të jashtëzakonshëm, kryesorë, dytësorë);
- shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;
- interpreton simbolikën e një personazhi (nëse ka të tillë);
- analizon ndërlikimin e marrëdhënieve njerëzore dhe të sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve.

#### **c) Mjedisi, koha dhe atmosfera**

Nxënësi:

- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare;
- veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën;
- përshkruan ndikimin e tij emocional dhe psikologjik nga leximi i një veprë letrare;
- analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.

#### **d) Tematika**

Nxënësi:

- dallon temën dhe motivet e një teksti;
- analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar;

|  |   |
|--|---|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës.</li> </ul> <p><b>e) Stili dhe gjuha</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst;</li> <li>- analizon dhe vlerëson gjuhën e figurshme;</li> <li>- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti.</li> </ul> <p><b>Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gjykon rreth kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;</li> <li>- shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.</li> </ul> <p><b>Lidhja mes tekstit dhe lexuesit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst;</li> <li>- tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.</li> </ul> <p><b>Reflektimi ndaj tekstit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme;</li> <li>- reflekton në mënyrë kritike përmes analizave, interpretimit, vlerësimit, krahasimit dhe sintezës së tekstit;</li> <li>- shprehet në mënyra të ndryshme për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj.</li> </ul> <p><b>Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;</li> <li>- organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).</li> </ul> |
| <b>Vlerat dhe qëndrimet</b>  |   |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi vullnet dhe vetëbesim kur analizon një vepër letrare;</li> <li>- vlerëson kontributin e shkrimtarëve të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore;</li> <li>- ndërmerr iniciativa dhe shpreh interesim për çështje të ndryshme që kanë lidhje me</li> </ul> |   |

letërsinë;

- përfshihet dhe është aktiv në detyra dhe në projekte të ndryshme me natyrë letrare;
- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit gjatë të lexuarit dhe të shkruarit;
- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup;
- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;
- respekton trashëgiminë kulturore dhe artistike të popullit tonë;
- përdor dhe vlerëson gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura.

### **KOMPETENCA: VLERËSIMI I LETËRSISË SHQIPE DHE ASAJ BOTËRORE NË PERIUDHA TË NDRYSHME LETRARE DHE HISTORIKE**

#### **Rezultatet e të nxënimit për këtë kompetencë**

Nxënësi:

- analizon dhe vlerëson karakteristikat kryesore të letërsisë së shekullit XX, drejtimet kryesore letrare, gjinitë letrare që u lëvruan, si dhe autorët përfaqësues dhe veprat e tyre;
- analizon dhe vlerëson periudhat kryesore në letërsinë shqipe të shekullit XX, grupimet dhe drejtimet letrare, autorët përfaqësues dhe veprat e tyre;
- analizon në rrafsh krahasues vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj europiane dhe botërore;
- analizon dy vepra letrare dhe përcakton të përbashkëtat dhe ndryshimet mes tyre;
- gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.

#### **Njohuritë**

#### **Shkathësitë**

##### **Letërsia botërore e shekullit XX**

- Kushtet historike dhe shoqërore të gjysmës së parë të shekullit XX.
- Zhvillimet e shkencës në shekullin XX që patën ndikim në letërsi.
- Veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e drejtimeve letrare, individualitete krijuese të spikatura dhe origjinale, veçori kombëtare të krijuesve.
- Prirja realiste e letërsisë së shekullit XX. Lidhja me letërsinë e traditës dhe risitë. Drejtimet, përfaqësuesit kryesorë, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan.
- Prirja moderniste e letërsisë. Pararendësit e letërsisë moderne.

##### **Letërsia botërore e shekullit XX**

Nxënësi:

- përshkruan dhe analizon kushtet historike në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe;
- analizon dhe gjykon pasojat që shkaktuan dy luftërat botërore;
- përshkruan dhe analizon realitetin shoqëror në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe;
- rendit disa nga zbulimet e mëdha në shkencat e natyrës, të cilat ndikuan në jetën e njeriut;
- përcakton dhe analizon zhvillimet në shkencat shoqërore, si: psikologjia, filozofia, sociologjia;
- gjykon për ndikimet e Frojdit, Sartrit, Kamysë etj., në letërsinë e shekullit XX;
- dallon dhe analizon veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e

|  |  |
|--|--|
| <p>Drejtimit (rrymat) kryesore moderniste (simbolizmi, surrelizmi, ekspresionizmi, ekzistencializmi etj.). Përfaqësuesit kryesorë. Gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan.</p>  | <p>drejttimeve letrare, individualitete krijuese të spikatura dhe origjinale, veçori kombëtare të krijuesve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton dhe analizon tiparet e letërsisë që vijoi traditën realiste të shekullit XIX;</li> <li>- analizon risitë që sollën shkrimtarët që ndoqën rrugën e letërsisë realiste të shekullit XIX;</li> <li>- rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsive të vendeve të ndryshme, si dhe veprat e tyre letrare;</li> <li>- përcakton gjinitë dhe llojet letrare që lëvruan më shumë shkrimtarët që ndoqën prirjen realiste (Drajzer, Remark, Cvajg, Heminguej etj.);</li> <li>- përcakton veçoritë kryesore të letërsisë moderniste;</li> <li>- dallon dhe analizon drejtimit (rrymat) kryesore letrare të letërsisë moderne të shekullit XX;</li> <li>- analizon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shekullit XX;</li> <li>- rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë moderne, si dhe veprat e tyre letrare.</li> </ul> |
| <p><b>Franc Kafka</b> (<i>sugjerohen 4 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Momentet kryesore të jetës së Kafkës, të cilat ndikuan në krijimtarinë letrare të tij.</li> <li>- Faktorët objektivë historikë që ndikuan në veprën e Kafkës.</li> <li>- Qëndrimi i Kafkës ndaj burokratizmit, gjyqit dhe vetëgjyqësisë, lirisë etj.</li> <li>- Tematika kryesore e krijimtarisë letrare të Kafkës.</li> <li>- Veçoritë kryesore të krijimtarisë së Kafkës (konceptimi universal, humanizmi, situatat absurde etj.</li> </ul> | <p><b>Franc Kafka: “Metamorfoza”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson rëndësinë që ka krijimtaria e Kafkës në letërsinë e shekullit XX;</li> <li>- përshkruan dhe analizon faktorët historikë objektivë që ndikuan në veprën e Kafkës;</li> <li>- analizon dhe gjykon qëndrimin e Kafkës ndaj burokratizmit, gjyqit dhe vetëgjyqësisë, lirisë etj.;</li> <li>- veçon veprat kryesore të Kafkës (tregime, novela, romane, ese);</li> <li>- analizon temat kryesore të veprave të Kafkës;</li> <li>- përshkruan dhe analizon veçoritë kryesore të krijimtarisë letrare të Kafkës;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson novelën “Metamorfoza”.</li> </ul>   |
| <p><b>Albert Kamy</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p>  | <p><b>Albert Kamy: “I huaji”</b></p> <p>Nxënësi:</p>   |



|   |   |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së Kamysë. Evoluimi krijues i Kamysë.</li> <li>- Ekzistencializmi në artin e Kamysë. Absurdi i qenies njerëzore, vetmia etj.</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkruan gjendjen absurde të Francës në kushtet e pushtimit nazist;</li> <li>- formulon idenë e Kamysë për absurdin;</li> <li>- analizon raportin: absurd, shpërfillje, shpresë, revoltë, në veprën e Kamysë;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “I huaji”.</li> </ul>  |
| <p><b>Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtet historike e shoqërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.</li> <li>- Risitë e letërsisë së kësaj periudhe.</li> <li>- Shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre janë urë lidhëse me letërsinë e shekullit XIX (Asdreni, Mjeda).</li> <li>- Krijimtaria letrare e kësaj periudhe dhe përfaqësuesit, si: Konica, Fishta, Noli, Migjeni, Poradeci, Migjeni, Koliqi, Kuteli etj.</li> </ul> | <p><b>Letërsia shqipe e shekullit XX</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton dhe analizon kushtet historike (Shpallja e Pavarësisë, Lufta e Parë Botërore etj.) dhe shoqërore në të cilat u zhvillua letërsia e gjysmës së parë të shekullit XX;</li> <li>- përshkruan dhe analizon risitë e letërsisë së kësaj periudhe;</li> <li>- rendit dhe analizon shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre shërbyen si urë lidhëse mes letërsisë së shekullit XIX dhe letërsisë së shekullit XX</li> <li>- rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së kësaj periudhe dhe krijimtarinë e tyre;</li> <li>- vlerëson kontributin e shkrimtarëve të kësaj periudhe;</li> <li>- gjykon për vlerat dhe kontributin e revistës “Albania” të Konicës në botën shqiptare.</li> </ul> |
| <p><b>Gjergj Fishta</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontributi i Gjergj Fishtës në botën shqiptare (publicistikë, letërsi, politikë etj.).</li> <li>- Momentet kryesore të jetës së Fishtës që ndikuan në krijimtarinë e tij.</li> <li>- Veprat letrare të Fishtës në poezi dhe dramë.</li> <li>- Idetë universale në veprën e Fishtës dhe mesazhet që i sjellin kohës sonë.</li> </ul>  | <p><b>Gjergj Fishta: “Lahuta e Malcis”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson kontributin e Fishtës në publicistikë, politikë, çështjet kombëtare, teologji, letërsi;</li> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës që ndikuan në krijimtarinë letrare të Fishtës;</li> <li>- rendit veprat kryesore të Fishtës (poema “Lahuta e Malcis, poezitë, dramet etj.);</li> <li>- analizon idetë universale në veprën e Fishtës dhe përshkruan mesazhet që i sjellin kohës sonë;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poemën “Lahuta e Malcis”.</li> </ul>  |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Lasgush Poradeci</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Poeti modern i shqipes.</li> <li>- Momentet më të rëndësishme të jetës së Poradecit që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprat e Poradecit.</li> <li>- Vendlindja dhe dashuria në jetën e Poradecit.</li> <li>- Mbështetja në trashëgiminë poetike të Naimit dhe në letërsinë moderne të Europës.</li> </ul>  | <p><b>Lasgush Poradeci: “Ylli i zemrës”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon risitë dhe origjinalitetin që solli Poradeci në poezinë shqipe;</li> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës së Poradecit që ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- rendit veprat kryesore të Poradecit;</li> <li>- analizon motivet kryesore të poezisë;</li> <li>- veçon dhe gjykon ndikimet që pati Poradeci nga krijimtaria e Naim Frashërit dhe nga poezia moderne e Evropës;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Ylli i zemrës”.</li> </ul>   |
| <p><b>Migjeni</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fryma e re që solli Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje), si p.sh.: shképutja nga tradita, temat e ndaluara, vargu i lirë, shembja e kulteve politike, fetare etj.</li> <li>- Burimet kryesore që përcaktuan formimin e Migjenit. Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së tij.</li> <li>- Njeriu në letërsinë e Migjenit (jeta në situata ekzistenciale).</li> </ul> | <p><b>Migjeni: “Novelat e qytetit të veriut” dhe “Vargjet e lira”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerëson frymën e re që sjell Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje), si p.sh.: shképutjen nga letërsia pararendëse, trajtimin e temave tabu, vargu i lirë etj.;</li> <li>- identifikon burimet kryesore që përcaktuan formimin e Migjenit;</li> <li>- përshkruan momentet kryesore të jetës dhe të veprës së Migjenit;</li> <li>- portretizon njeriun në krijimtarinë e Migjenit, duke e krahasuar edhe me krijimtarinë e letërsisë së mëparshme, por edhe me letërsinë e kohës së tij;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin në prozë “Novelat e qytetit të veriut”;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Vargjet e lira”.</li> </ul> |
| <p><b>Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore</b> (<i>Panoramë e përgjithshme</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore.</li> <li>- Dukuritë letrare.</li> <li>- Letërsia shqipe në Kosovë dhe në diasporë.</li> </ul>  | <p><b>Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore;</li> <li>- përshkruan, analizon dhe gjykon për dukuritë letrare të kësaj periudhe;</li> <li>- analizon veçoritë kryesore të letërsisë shqipe në Kosovë dhe në diasporë;</li> <li>- veçon përfaqësuesit kryesorë të letërsisë shqipe në Kosovë dhe në diasporë.</li> </ul>  |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Dritëro Agolli</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Risitë që solli Agolli në letërsinë shqipe.</li> <li>- Momentet kryesore të jetës së Dritëro Agollit që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprimtaria shoqërore dhe politike e Agollit.</li> <li>- Krijimtaria letrare e Agollit në poezi, prozë dhe dramë. Krijimtaria e Agollit pas viteve '90.</li> <li>- Atdheu dhe historia në poezinë e Agollit.</li> <li>- Veçoritë e prozës së Agollit.</li> </ul> | <p><b>Dritëro Agolli: “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon risitë që solli Agolli në letërsinë shqipe;</li> <li>- përshkruan dhe analizon momentet kryesore të jetës së Dritëro Agollit që ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- përshkruan dhe analizon veprimtarinë shoqërore dhe politike të Agollit;</li> <li>- rendit veprat kryesore të Agollit në prozë, poezi dhe dramë;</li> <li>- veçon dhe analizon risitë që sjell Agolli në letërsi pas viteve '90;</li> <li>- interpreton dhe gjykon për vendin që zënë atdheu dhe historia në poezinë e Agollit;</li> <li>- analizon veçoritë e prozës së Agollit;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo”.</li> </ul>   |
| <p><b>Ismail Kadare</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprimtaria e Kadaresë si artist dhe intelektual. Vendi që zë Kadare në letërsinë shqipe.</li> <li>- Momentet kryesore të jetës së Kadaresë që ndikuan në krijimtarinë e tij.</li> <li>- Poeti dhe prozatori.</li> <li>- Krijimtaria letrare e Kadaresë para dhe pas viteve '90.</li> <li>- Bota shqiptare në veprën e Kadaresë.</li> </ul>  | <p><b>Ismail Kadare: “Pallati i ëndrrave”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcakton sferat e kulturës shqiptare në të cilat shtrihet veprimtaria e Ismail Kadaresë si artist dhe si intelektual;</li> <li>- analizon momentet kryesore të jetës së Ismail Kadaresë që ndikuan në krijimtarinë e tij;</li> <li>- përshkruan dhe analizon veprimtarinë shoqërore dhe politike të Kadaresë;</li> <li>- rendit veprat kryesore të Kadaresë në prozë, poezi dhe dramë;</li> <li>- analizon veçoritë e prozës dhe po;</li> <li>- veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsi para viteve '90;</li> <li>- veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsi pas viteve '90;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Pallati i ëndrrave”.</li> </ul> |
| <p><b>Martin Camaj</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Momentet kryesore të jetës së Martin Camajt që ndikuan në krijimtarinë e tij.</li> </ul>  | <p><b>Martin Camaj: “Njeriu më vete e me tjerë”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- veçon faktorët jetësorë që ndikuan në krijimtarinë e Camajt;</li> </ul>   |

|  |  |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>- Risitë që solli Camaj në letërsinë shqipe.</li> <li>- Fazat e krijimtarisë së Camajt.</li> <li>- Camaj si poet dhe si prozator.</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon risitë që solli Camaj në letërsinë shqipe;</li> <li>- vlerëson përpjekjet e Camajt për t'i bërë universale, elemente të ndryshme të botës shqiptare;</li> <li>- analizon tiparet e çdo faze të krijimtarisë së Camajt;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Njeriu më vete e me tjerë”.</li> </ul>   |
| <p><b>Azem Shkreli</b> (<i>sugjerohen 5 orë</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Momentet kryesore të jetës së Shkrelit që ndikuan në krijimtarinë e tij.</li> <li>- Veprat kryesore të Shkrelit (në prozë dhe në poezi).</li> <li>- Risitë që solli Shkreli në letërsinë shqipe.</li> <li>- Tiparet e poezisë së Shkrelit.</li> </ul>  | <p><b>Azem Shkreli: “Lirikë me shi”</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon faktorët jetësorë që ndikuan në krijimtarinë e Azem Shkrelit;</li> <li>- rendit veprat kryesore të Azem Shkrelit;</li> <li>- analizon dhe vlerëson risitë që solli Shkreli në poezinë shqipe;</li> <li>- përcakton tiparet e poezisë së Shkrelit, si dendësia e mendimit, mjeshtëria e vargut dhe frazës poetike, çlirimi i unit lirik etj.;</li> <li>- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson vëllimin poetik “Lirikë me shi”.</li> </ul> |
| <b>Vlerat dhe qëndrimet</b>  |  |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ka dëshirë dhe kuriozitet për të lexuar letërsi artistike;</li> <li>- përfshihet në diskutime rreth letërsisë duke dhënë kontributin e tij;</li> <li>- përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>- përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në procesin e të nxënës;</li> <li>- demonstroi vullnet dhe gatishmëri në detyrat individuale dhe në punët në grup që kanë lidhje me çështje të ndryshme rreth letërsisë;</li> <li>- respekton parimet, vlerat, bindjet dhe kulturën e të tjerëve;</li> <li>- vlerëson trashëgiminë letrare shqipe dhe botërore;</li> <li>- përdor dhe vlerëson gjuhën standarde shqipe dhe pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;</li> <li>- tregon vetëbesim, imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë punëve të pavarura;</li> <li>- tregon kureshtje për të hulumtuar njohuri të reja.</li> </ul> |  |

## IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Vitet e fundit, në praktikën e shkollës sonë flitet për metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Kështu, gjithnjë dhe më tepër po zënë vend terma, të tillë si: mësimdhënia ndërvepruese, mësimdhënia me nxënësin në qendër, mësimdhënia e mbështetur në përdorimin e metodave për zhvillimin e mendimit kritik, puna me projekte etj.

Mësuesit të letërsisë, më shumë se çdo mësuesi tjetër, metodat dhe zhvillimet e mësipërme i japin mundësi që të zhvillojë një mësimdhënie cilësore, i krijojnë mundësi që nxënësit të lexojnë, të hulumtojnë, të krahasojnë dhe të nxjerrin përfundime për veprën letrare në të gjithë komponentët e saj.

Me mësimdhënie ndërvepruese kuptojmë përdorimin e veprimtarive që nxitin punën në grup. Bashkëpunimi i nxënësve me njëri-tjetrin në procesin e të nxënësve të bën më efektiv dhe më të kënaqshëm mësimin. Pedagogjia bashkëkohore thekson faktin që nxënësit mund të mësojnë nga njëri-tjetri.

Puna me projekte është një nga format më të larta të veprimtarisë mësimore. Ajo i përfshin nxënësit në detyra me nivel të lartë kërkimor dhe hulumtues. Mësimdhënia e mbështetur në punën me projekte kërkon nga mësuesit që t'u japin nxënësve kohën e duhur për të përgatitur projektet e tyre për çështje të caktuara me natyrë letrare. Ndërkohë, nxënësit socializohen, ndërveprojnë duke folur apo duke diskutuar me njëri-tjetrin, ata mësojnë të punojnë së bashku duke respektuar individualitetin e gjithsecilit dhe bëhen kompetentë të punës që ata paraqesin. Metodatat e mendimit kritik janë prezent, tashmë, në kontekstin e sotëm shkollor. Mësuesit e letërsisë duhet t'i bëjnë këto metoda pronë të punës së tyre mësimore. Përdorimi i tyre gjatë orës së mësimin u shërben nxënësve për të bërë gjykimin dhe vlerësimin e veprave dhe të autorëve duke i parë në këndvështrime dhe në qasje të ndryshme. Po kështu, metodatat e mendimit kritik bëjnë që nxënësit të jenë aktivë në analizën e veprave letrare dhe në mënyrë logjike t'i lidhin ato me rrethanat politike, sociale apo personale. Të parit me sy kritik bëhet, vetvetiu, pronë e nxënësve në këtë lëndë. Po kështu, metodologjia e përzgjedhur bën që studimi i veprave dhe i fragmenteve letrare sipas periudhave, të nxjerrë në pah tiparet e veçanta të tyre dhe të zhvillojë te nxënësit të përgjithësuarit dhe nxjerrjen e përfundimeve të qarta.

### **Parimet e mësimdhënies së lëndës së letërsisë**

Parimet që udhëheqin mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në këtë lëndë, janë: angazhimi personal, vlerësimi kritik dhe lidhjet kuptimplote.

### **Angazhimi personal**

Mësuesit:

- do të krijojnë në klasë një mjedis pozitiv, në të cilin nxënësit të diskutojnë dhe të vlerësojnë tekste të ndryshme letrare;
- do të mundësojnë që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur me tekstet, të krijojnë përshtypjet dhe gjykimet e tyre, si dhe t'i ndajnë ato me të tjerët.

### **Vlerësimi kritik**

Mësuesit:

- do të zhvillojnë te nxënësit aftësitë për vlerësuar në mënyrë kritike tekstet letrare;
- do të nxisin nxënësit që të mbrojnë gjykimet dhe vlerësimet e tyre me shembuj dhe ilustrime nga teksti.

### **Lidhjet kuptimplote**

Mësuesit:

- do të udhëzojnë nxënësit që të bëjnë lidhje mes teksteve letrare, mes tekstit letrar dhe jetës së tyre, si dhe mes tekstit letrar dhe botës që i rrethon;
- do të nxisin te nxënësit dashurinë për letërsinë duke u dhënë mundësinë të njihen dhe të studiojnë vepra të gjinive dhe llojeve të ndryshme nga letërsia shqipe dhe ajo botërore.

### **Kërkesa të veçanta të lëndës së letërsisë**

Mësimdhënia e letërsisë duhet të synojë zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve, në mënyrë që ata të shijojnë dhe të vlerësojnë letërsinë në mënyrë kritike. Për të realizuar këtë, mësuesit duhet të përdorin si artin, ashtu edhe shkencën e mësimdhënies. Përmbajtja e lëndës do të ketë karakter të theksuar zbatues, duke mënjanuar e minimizuar karakterin parashtrues dhe informues. Në thelb, procesi mësimor ka qasjen nga të gjithë nxënësit, pavarësisht nga dallimet e tyre në interesa, të njohurive dhe të shprehive paraprake. Ndaj, në qendër të zbatimit të programit është ballafaqimi i drejtpërdrejtë i nxënësit me veprën, aftësimi i tij për të evidentuar vlerat, për të mbajtur një qëndrim të tijin ndaj veprës, duke shmangur kështu parashtrimin e njëanshëm të saj nga mësuesi.

Në fillim të lëndës, mësuesi duhet t'i njohë nxënësit me natyrën e zhvillimit të saj, me përmbajtjen, si dhe me çështjet që do të trajtohen. Në qendër do të jetë puna e pavarur dhe në grupe e nxënësve për të kuptuar konceptet e strategjitë bazë që mundësojnë analizën e pavarur të veprës letrare. Proces i të nxënësve do të mbështetet shumë në hulumtimin e informacionit dhe në lirinë e përzgjedhjes e të shprehjes së mendimeve të nxënësit për autorin dhe veprën letrare.

#### **a) Rolet e mësuesit**

Mësuesi është lehtësues dhe rregullator në procesin e mësimdhënies. Ai luan rol kyç për të zhvilluar aftësitë e nxënësve për nxënie të pavarur. Për të realizuar misionin e tij, mësuesi:

- sqaron me nxënësit qëllimet e lëndës dhe përmbajtjen mësimore;
- krijon një atmosferë pozitive për procesin e të nxënësve;
- nxit dhe mbështet pjesëmarrjen aktive të nxënësve;
- përshtat mësimdhënien me interesat dhe reagimet e nxënësve;
- punon me nivele të ndryshme nxënësish dhe përshtat mësimdhënien në varësi të tyre;
- nxit cilësinë e bashkëveprimit në klasë;
- jep orientimet e duhura dhe vlerëson “kontributet” e nxënësve në procesin mësimor;
- përgatit dhe përzgjedh instrumente didaktike për aftësimin e nxënësit në analizën e pavarur të veprës letrare.

#### **b) Rolet e nxënësve**

Për nxënësit, më të rëndësishme janë shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet që duhen zhvilluar, krahasuar me një grup njohurish që duhen marrë. Mësuesi duhet të sigurojë mbështetje dhe inkurajim, në mënyrë që nxënësit të lexojnë me dëshirë vepra letrare, si dhe të gjykojnë në mënyrë kritike për to. Nxënësit duhet të ushtrojnë imagjinatën e tyre, të reagojnë me emocion dhe të krijojnë tekstet e tyre. Për të shpjeguar qartë opinionet dhe idetë e tyre, në një punë grupi, nxënësit duhet të zhvillojnë një fjalor kritik. Ndërkohë që bëjnë kritikën e teksteve, nxënësit kanë nevojë t’u besohet, të reflektojnë dhe të jenë të gatshëm të ndajnë me të tjerët punimet e tyre me shkrim. Nxënësit, gjatë vitit mësimor dhe në përfundim të tij, duhet të bëjnë përzgjedhjen e punimeve për të ndërtuar dosjen e punimeve të tyre.

## V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi korrekt dhe sistematik i nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi i nxënësve nuk ka për synim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Ai duhet të shërbejë për disa qëllime, si:

- të sigurojë informacion rreth nivelit të arritjeve të nxënësve;
- të motivojë nxënësit;
- të shënojë përparimin e nxënësve;
- të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Gjatë procesit mësimor, mësuesit:

- duhet të identifikojnë nevojat dhe mangësitë e nxënësve në procesin e të nxënësve dhe të ndjekin strategjitë dhe metodat e duhura për të përmirësuar nivelin e të nxënësve;
- duhet t'u ofrojnë nxënësve mundësi, veprimtari dhe detyra të shumta e kuptimplote, në mënyrë që të zhvillojnë dhe të demonstrojnë aftësitë dhe progresin e tyre;
- duhet t'i udhëzojnë, t'i motivojnë dhe t'i nxisin nxënësit për të përmirësuar rezultatet e tyre;
- duhet t'i qartësojnë nxënësit për qëllimin dhe kriteret e vlerësimit;
- duhet t'i përfshijnë nxënësit në procesin e vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet në rezultatet e të nxënësve të programit lëndor. Gjatë zbatimit të programit, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup për kryerjen e detyrave, të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi, dhe të secilit nxënësi, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimi. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirëkryerjes së detyrave jashtë klase.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë një periudhe kohore. Ai mund të përmbajë detyra me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndër-lëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, ndërsa mësuesi, në këtë rast, rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni ose të fëmijëve të shtetasve të huaj, banues në vendin tonë, merren parasysh nga mësuesit, duke u mundësuar këtyre nxënësve që të vlerësohen me mënyra të posaçme.

Mësuesi duhet t'u komunikojë prindërve, stafit pedagogjik të shkollës, organeve shtetërore dhe palëve të tjera të interesuara, herë pas here, rezultatet e përparimit të nxënësve. Ky komunikim



është mirë të jetë me shkrim dhe të përmbajë disa aspekte kryesore të punës së nxënësve, si: aftësitë, qëndrimi ndaj lëndës, pjesëmarrja në veprimtari, detyra me shkrim, sugjerime për përmirësimin e punës në të ardhmen etj.

### **Llojet e vlerësimit në letërsi**

Vlerësimi dhe mësimdhënia janë të shkrira midis tyre brenda kurrikulës, në një mënyrë të pazgjydhshme. Por, për ta përdorur vlerësimin brenda mësimdhënies në mënyrë efektive, kërkohet, mbi të gjitha, të njihet fakti se instrumente të ndryshme të tij duhet të përdoren për qëllime të ndryshme. Vlerësimet e mëposhtme janë vendimtare për arritjen e rezultateve të të nxënësve, të vendosura në lëndën e letërsisë.

**Vlerësim diagnostikues** kryhet, zakonisht, në fillim të nivelit, vitit shkollor, ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikën e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

**Vlerësimi për të nxënë** (i vazhdueshëm) është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit dhe mësuesit mbi progresin e nxënësve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga ky lloj vlerësimi përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Fokusi i vlerësimit nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit.

**Vlerësimi i të nxënësve** (përmbledhës) kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh, për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe, dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet e të nxënësve përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në situata të njohura dhe të panjohura. Nëse nxënësit i zotërojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet në mënyrë të mjaftueshme, ata duhet t'i zbatojnë ato përtej materialeve të përdorura gjatë mësimdhënies. Vlerësimi i të nxënësve nuk është thjesht një reflektim i njohurive të fituara, por edhe një tregues i vlefshëm dhe i besueshëm i thellësisë së të kuptuarit dhe mënyrës se si ai transmetohet dhe përgjithësohet.

Të marra së bashku, të tria llojet e vlerësimeve formojnë një hartë të plotë për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve, e cila përfshin pikën e nisjes, rrugën që duhet ndjekur dhe pikëmbërritjen.

## VI. ELEMENTET QË DO TË STUDIOHEN NË TEKSTET LETRARE

Elementet e ndryshme që do të studiohen në veprat letrare, janë ato elemente që e karakterizojnë tekstin letrar, si të tillë. Ato janë përshkruar më poshtë dhe renditja e tyre nuk është bërë sipas rëndësisë ose shkallës së vështirësisë. Ato nuk duhen studiuar të izoluara ose të ndara nga njëra-tjetra, por të gjitha së bashku. Kështu, ato krijojnë një kornizë brenda së cilës nxënësit nxiten për të interpretuar, për të analizuar, për të reflektuar dhe për të vlerësuar tekstet letrare.

Natyrisht, këto elemente mund të mos jenë të pranishme në të gjitha tekstet letrare me të cilat do të njihen nxënësit, si p.sh., në një poezi nuk mund të diskutosh për personazhet dhe tiparet e tyre.

Ato janë:

### - **Fabula dhe subjekti**

Me fabul dhe subjekt kuptohen ngjarjet ose ndodhitë brenda një teksti, si dhe lidhja me njëra-tjetrën.

### - **Personazhet**

Nxënësit analizojnë dhe vlerësojnë personazhet, mënyrën se si ata prezantohen, veprimet e tyre, marrëdhëniet me personazhet e tjera, cilësitë emocionale, morale, sociale dhe intelektuale.

### - **Koha, vendi, rrethanat dhe atmosfera**

Nxënësit duhet të diskutojnë për kohën dhe mjedisin ku zhvillohen ngjarjet në një tekst letrar, si dhe për kontekstin ku vendosen ato. Atmosfera ka të bëjë me gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat.


### - **Tematika**

Me tematikë kuptohet çështja/çështjet kryesore që trajtohen në një tekst letrar.

### - **Stili dhe gjuha**

Me stil kuptohet përdorimi i qëllimshëm i gjuhës nga ana e shkrimtarit, me qëllim që të arrijë efekte të caktuara. Gjuha ka të bëjë me përdorimin e qëllimshëm të një ligjërimi apo leksiku të orientuar nga tematika apo qëllimi i autorit.

Diagrami i mëposhtëm pasqyron lidhjen mes këtyre elementeve.



## 1. Autorët dhe veprat e sugjeruara në arsimin e mesëm e lartë

Në tabelën e mëposhtme janë sugjeruar disa autorë dhe vepra letrare që do të studiohen përgjatë tri viteve. Këto vepra duhet të lexohen të plota nga nxënësit. **Analiza dhe studimi i këtyre veprave (së bashku me autorin) sugjerohet të zhvillohen në rreth 5 orë mësimi.**

Mësuesit janë të lirë që, përveç këtyre autorëve dhe veprave të sugjeruara, të punojnë me nxënësit edhe autorë ose vepra të tjera të këtyre periudhave ose të letërsisë bashkëkohore shqipe dhe botërore. Këto mund të realizohen në trajtën e projekteve ose të bisedave letrare.

| NR  | KLASA X  | KLASA XI                                      | KLASA XII   |
|-----|--|---|---|
|     | <b>Folklor</b><br><b>Antikiteti –Shekulli XVIII</b>                    | <b>Letërsia e shekullit XIX</b>               | <b>Letërsia e shekullit XX</b>  |
| 1.  | <b>Cikli i kreshnikëve</b>   | <b>Gëte</b><br>“Fausti”                       | <b>Franc Kafka</b><br>“Metamorfoza”                                     |
| 2.  | <b>Homeri</b><br>“Iliada”  | <b>Hygo</b><br>“Katedralja e Parisit”         | <b>Albert Kamy</b><br>“I huaji”   |
| 3.  | <b>Eskili</b><br>“Prometeu i mbërthyer”                                | <b>Bajron</b><br>“Shtegtimet e Çajld Harold”  | <b>Gjergj Fishta</b><br>“Lahuta e Malcis”                               |
| 4.  | <b>Euripidi</b><br>“Medea”   | <b>De Rada</b><br>“Këngët e Milosaos”         | <b>Lasgush Poradeci</b><br>“Ylli i zemrës”                              |
| 5.  | <b>Aligeri</b><br>“Ferri”  | <b>N. Frashëri</b><br>“Lulet e verës”         | <b>Migjeni</b><br>“Novelat e qytetit të veriut”<br>dhe “Vargjet e lira” |
| 6.  | <b>Barleti</b><br>“Histori e Skënderbeut”                              | <b>Balzak</b><br>“Xha Gorio”                  | <b>Dritëro Agolli</b><br>“Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”            |
| 7.  | <b>Bogdani dhe Budi</b><br>“Këngët e sibilave” dhe disa poezi të Budit | <b>Flober</b><br>“Zonja Bovari”               | <b>Ismail Kadare</b><br>“Pallati i ëndrrave”                            |
| 8.  | <b>Servantes</b><br>“Don Kishoti i Mançës”                             | <b>Dostojevski</b><br>“Vëllezërit Karamazovë” | <b>Martin Camaj</b><br>“Njeriu më vete e me tjerë”                      |
| 9.  | <b>Shekspiri</b><br>“Hamleti”  | <b>Bodler</b><br>“Lulet e së keqes”           | <b>Azem Shkreli</b><br>“Lirikë me shi”                                  |
| 10. | <b>Molieri</b><br>“Tartufi”  |   |   |

## 2. Leximet jashtë klase dhe bisedat letrare

Përveç veprave të detyrueshme për t’u lexuar, këshillohet që, brenda një viti shkollor, të studiohen edhe 1-2 vepra për projekte ose biseda letrare. Orët për projekte ose biseda letrare, mësuesit duhet t’i vendosin në planin e tyre mësimor, kur të bëjnë zbrëthimin analitik të programit. Është e rëndësishme që gjatë këtyre orëve, nxënësve t’u krijohet mundësia të zgjedhin edhe vepra që janë të pëlqyera e të preferuara për ta.

**Veprat e rekomanduara për projekte ose biseda letrare duhet të jenë:**

- )] nga letërsia shqipe dhe nga letërsia botërore;
- )] nga autorë të periudhave të ndryshme;

) nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare.

Përzgjedhja e projekteve ose e bisedave letrare nga autorë të ndryshëm, periudha të ndryshme, nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare krijon mundësi për pasurimin e përvojës letrare të nxënësve. Këto vepra duhet të jenë brenda listave rekomanduese të MASR-së.

## VII. MATERIALET, BURIMET MËSIMORE, MJEDISET E TË NXËNIT

Për arritjen e kompetencave, në lëndën e letërsisë është me rëndësi përdorimi i mjeteve dhe i materialeve të shumta mësimore, për të krijuar mundësi që nxënësit të ndërtojnë dijet e tyre, t'i konkretizojnë njohuritë e tyre, të nxënë në mënyrë të pavarur, t'i përdorin dijet në jetën praktike dhe në kontekste të reja, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik e krijues, të bashkëveprojnë me shokët e shoqet e klasës. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë: tekstet shkollore (të shtypura dhe digjitale), veprat letrare (veprat letrare mund të sigurohen nga biblioteka e shkollës), revistat, atlasat, enciklopeditë, antologjitë, televizori, videoprojektori, kompjuteri, interneti, CD-të etj.

Pjesa më e madhe e orëve të mësimi zhvillohet në klasë, ku mundësohen punët në grupe, dramatizimet, tryezat e rrumbullakëta etj. Gjithashtu, gjatë vitit mësimor nxënësit mund të shkojnë në biblioteka, të marrin pjesë në panairë të librit, të shkojnë në teatër ose kinema, të zhvillojnë takime me shkrimtarë, të vënë në skenë pjesë dramatike etj.